



## Kush mund të kerkojë hapjen e procedurave të falimentimit?

- 1- **debitori; ose**
- 2- **çdo kreditor.**

1- **Debitori bën kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të paaftësinë paguese ekzistuese ose paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt të tij.**

2- **Kreditori duhet të depozitojë një kërkesë me shkrim në gjykatën e falimentimit ku duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar nga ana e debitorit ndaj tij.**

*-Gjykata e Falimentimit ku debitori ka qendrën e interesit ose vendbanimin e tij nis procesin duke verifikuar kushtet ligjore dhe merr vendime në raport me kërkesat e palëve brenda afateve të parashikuara në ligj.*

## SUBJEKTET

Rrethi i subjekteve, tek të cilët shtrin efektet e veta falimentimi përfshin:

- personat fizikë (të tillë si individë apo tregtarë);
- personat juridikë (shoqëritë tregtare me kapital publik ose shtetëror)

## Pasojat juridike të falimentimit

- Në përfundim të procesit **debitori shkarkohet nga cdo detyrim i pranuar** duke rifituar lirinë financiare.
- Veprimtaria tregtare e debitorit vazhdon edhe **pas fillimit** të procedurës së falimentimit.
- Debitori ka të drejtë që **shpenzimet minimale të jetesës** të sigurohen nga masa e falimentimit;

- Fillimi i procedurës së falimentimit **nuk ka asnjë ndikim në vazhdimësinë e një kontrate** që nuk është përmbushur plotësisht nga debitori dhe nga pala tjetër e saj.
- Debitori është në gjendje të marrë nga gjykata një **pezullim të përkohshëm të veprimeve përmbartimore individuale**, qoftë të dhëna nga një autoritet gjyqësor apo administrativ me qëllim mbështetjen e negociatave për një plan riorganizimi.



*Na kontaktoni për më tepër informacion:*

**AGJENCIA KOMBËTARE E  
FALIMENTIMIT**

website: <https://akf.gov.al/>

email: [Ak.falimenti@drejtesia.gov.al](mailto:Ak.falimenti@drejtesia.gov.al)